



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti
Mbledhja nr. 144/2024
Prishtinë, më 1.10.2024, në orën 18:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ferat Shala, kryetar, Jeta Statovci, zëvendëskryetare e parë, Fidan Jilta, zëvendëskryetare e dytë, Mimoza Kusari-Lila, Armend Muja, Driton Hyseni, Gramos Agusholli, Valentina Bunjaku - Rexhepi dhe Pal Lekaj, anëtarë.

Mungoi: Abelard Tahiri, anëtar.

Pjesëmarrës tjerë: Salih Hoxha, GP LVV; Festim Bytyçi, GP AAK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Ferat Shala, kryetar i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 1.10.2024 - I -;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të Panelit Përzgjedhës për zgjedhjen e Bordit të NP KOSTT – tri pozita;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 1.10.2024 -I-.

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 1.10.2024 -I-, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Panelit Përzgjedhës për zgjedhjen e Bordit të NP KOSTT – tri pozita

Kryetari, theksoi se Paneli Përzgjedhës për zgjedhjen e “Bordit në NP KOSTT për plotësimin e tri pozitave të lira (vakante)” më datë 26.9.2024 ka mbajtur takimin e parë, ku u konstatua se: për pozitën “Drejtor i Bordit në NP KOSTT - tri pozita”, sipas Ligjit për energji elektrike dhe Ligjit për ndërmarrje publike, është shpallur konkursi nga MPB-ja, më afat aplikimi nga data 6.6.2024, deri me datën 8.7.2024, ku kanë aplikuar njëzetekatër (24) aplikantë. Komisioni pranoi dosjen e aplikanteve nga ministria, më datën 16.7.2024, konstatoi se njëzetetë (23) i plotësojnë kushtet formale ligjore për tu ftuar në intervistë, përveçse për dy kandidatë kërkoi opinion lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit. Data e intervistës u caktuar më 1.10.2024, dhe u kërkua nga stafi i Komisionit që të ftohen kandidatët. Ndërkohë, që nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, më datën 27.9.2024, Paneli mori opinion lidhur me dy (2) kandidatët, për të cilët Paneli nxori përfundimin se s’mund të intervistohen. Ndërkaq, tre (3) kandidatë para intervistës njoftuan së tërhiqen nga gara. Paneli përgatiti pyetjet - të cilat ishin nga fushëveprimi i NP KOSTT-it, menaxhimi, zgjidhja e problemeve, integriteti dhe përvoja e kandidatit. Poentimi ishte: nga 1-5. Paneli zhvilloi intervistat, dhe erdhi në konstatim se: procesit intervistues iu nënshtruan tetëmbëdhjetë (18) kandidatë, duke marrë parasysh performancën e kandidatëve, Paneli vlerësoi, gjashtë kandidatët me më së shumti poena, si në vijim: Rejhane Zylfijaj (44 poena); Gëzim Tosuni (43 poena); Gazmend Mejzini (37 poena); Jeton Mehmeti (33 poena); Lumije Zeka (33 poena); dhe Pranvera Dobruna – Kryeziu (32 poena).

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- *Kuvendi të zgjedhë, me votim të fshehtë, tre (3) nga kandidatët/et, e propozuar për plotësimin e tri pozitave, për drejtor të Bordit të NP KOSTT, me mandat 4 (katër) vjeçar si në vijim:*
 1. *Rejhane Zylfijaj;*
 2. *Gëzim Tosuni;*
 3. *Gazmend Mejzini;*
 4. *Jeton Mehmeti;*
 5. *Lumije Zeka;*
 6. *Pranvera Dobruna - Kryeziu;*
- *Kandidati/ja që merr më së shumti vota nga Kuvendi, zgjidhet kryesues i Bordit të Drejtorëve të NP KOSTT.*

4. Të ndryshme Çështjet vijuese

**Mbledhja përfundoi në orën 18:15.
E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.**

Ferat Shala,

Kryetar i Komisionit